

“Forumi Transparenca”, Platforma e përbashkët e veprimit e aktivistëve të shoqërisë civile dhe gazetarëve në Prizren

31 mars 2014, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Themelohet “Forumi TRANSPARENCA”

Pas procesit të konsultimeve ndërmjet pjesëtarëve të shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të medieive, që ka zgatur për disa muaj dhe në përpjekje të gjetjes së formave për rritjen e transparencës institucionale, në muajin mars në Prizren është themeluar Platforma e përbashkët e veprimit të aktivistëve të shoqërisë civile dhe medias, e titulluar në mënyrë simbolike “Forumi Transparenca”.

Kjo platformë synon që të koordinojë dhe promovojë veprimet e aktivistëve të shoqërisë civile dhe gazetarëve që janë aktiv në fushën e qeverisjes demokratike, të rrisë vizibilitetin e punës së shoqërisë civile përmes prezencës së shtuar në mediat lokale dhe qendrore, pastaj të ngre aftësinë avokuese të shoqërisë civile për qeverisje më transparente dhe llogaridhënëse në Prizren, si dhe të ngre pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe të sigurojë që kërkesat e tyre merren parasys.

Ky trup joformal përbëhet nga aktivistë të shoqërisë civile dhe gazetarë të Prizrenit, të cilët janë aktiv në fushën e qeverisjes demokratike dhe misioni i tij është koordinimi i veprimeve të këtyre akterëve për të rritur nivelin e transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes lokale të Prizrenit. Gjatë vitit të parë të veprimit, EC Ma Ndryshe do të udhëheq Sekretariatit e Forumit, ndërsa aktivitetet e tij do të realizohen me ndihmën e projektit “Transparenca Online e komunës së Prizrenit”, që përkrahet financiarisht nga Ambasada Britanike në Prishtinë.

Pas konsultave të brendshme është arritur pajtimi që veprimet konkrete të kësaj platforme fillimisht të përfshijnë avokimin për miratimin dhe zbatimin e Planit të Veprimit për Transparençë në komunë, monitorimin e praktikave në hartimin, miratimin dhe shpenzimin e buxhetit komunal me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes qytetare, pastaj monitorimin e zbatimit të vendimeve dhe dokumenteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës, ndërkohë që do të krijohen forume publike të diskutimit mbi çështjet e qeverisjes demokratike dhe çështje të tjera.

Aktivitetet që janë paraparë të zhvillohen brenda këtij viti përfshijnë takimet e rregullta mes OJQ-ve dhe medieive, organizimin e tryezave të diskutimit dhe avokimin për qeverisje demokratike, pastaj hartimin e dokumentit “Forumi i qeverisjes demokratike në Prizren”, sikurse edhe debate ballafaqese me vendimmarrësit komunal, me pjesëtarë të komunitetit mbi qeverisjen demokratike, etj. Në këtë drejtim, Forumi “Transparenca” pret bashkëpunimin dhe mbështetjen e të gjithë akterëve të shoqërisë, në mënyrë që të avancohet qeverisja demokratike në Prizren.

Me respekt,
Në emër të Forumit “Transparenca”
Hajrulla Çeku, EC Ma Ndryshe